



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

Nr. 193 prot.

Tiranë, më 06.03.2020

Lënda: Dhënie mendimi për Projektvendimin e krijimit të ASKCKSHSH.

Z. ENVER ROSHI
KRYETAR
KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", Nr.4, Tiranë

I nderuar Z. ROSHI,

Inspektorati Qendror, studioi me shumë kujdes me një grup pune, propozimet në lidhje me ristrukturimin e ISHSH-së, dhe konstatoi se ky ri-organizim bie ndesh me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Për më tepër, nuk bazohet në metodologjinë e asnjë Inspektorati Shtetëror të vendeve të BE-së, bie ndesh me parimet dhe sugjerimet e OECD (Organizata për Zhvillim Ekonomik), sugjerimet e Inspektoratit të Përgjithshëm të Administratës Franceze (partner strategjik i Inspektoratit Qendror), me Twinning Project Against Corruption, pranë Delegacionit Evropian, si dhe me të gjitha komentet, sugjerimet e dhomave të biznesit, vendase e të huaja, që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në nenin 16, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", me anë të këtij relacioni të argumentuar ligjërisht, shprehim **mosdakordësimin** tonë, për miratimin e këtij projektvendimi.

Bashkëlidhur, do të gjeni komunikimet shkresore mbi dhënien e mendimit për këtë draft projektvendim.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
SHKËLQIM HAJBARI

